Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

1. **Gershere krasitje për degë të larta**
 - Materiali i tehut: **Çelik SK5 ose ekuivalent**
 - Gjatësia totale: **rreth 76 cm ±5%**
 - Diametri maksimal i prerjes: **deri 28 mm**
 - Veçori: Mekanizëm për zvogëlimin e stresit në teh
 - Teh i trajtuar termikisht (**ngrohje termike ose ekuivalente**)
2. **Gershere krasitje me zgjatim, çelik, 67.5-92.5 cm**
 - Gershere krasitje me zgjatim për degë
 - Maje: **tip papagall ose ekuivalent**
 - Gjatësia: **67.5–92.5 cm (±5%)**
 - Material: **çelik karboni ose ekuivalent**, i trajtuar termikisht
 - Shtresë mbrojtëse: **teflon ose ekuivalent**
3. **Gershere krasitje, 65-87 cm, strukturë metalike**
 - Material: **çelik special ose ekuivalent**, trajtim kundër ngjitjes
 - Siguresë sigurie për transport
 - Permasë tehu: **rreth 20 cm ±5%**
 - Përdorim: zakonisht në krasitjen e hardhive
4. **Zinxhir për motosharrë**
 - Përshtatshmëri: **universal për motosharra me shirit deri 40 cm ±10%**
 - Trashësi: **rreth 1.3 mm**
 - Material rezistent, mirëmbajtje e lehtë
 - I qëndrueshëm në përdorim të zgjatur
5. **Limë për mprehjen e zinxhirit të motosharrës**
 - Tipi: **skedar i rrumbullakët**
 - Gjatësia: **rreth 200 mm ±5%**
 - Material: **çelik T12 ose ekuivalent**
6. **Gershere krasitje 20 cm, me dorezë plastike**
 - Gjatësia: **20 cm ±5%**
 - Materiali i tehut: **çelik ose ekuivalent**
 - Dorezë ergonomike plastike
 - Mekanizëm sigurimi për mbyllje
7. **Filispanjë litar Ø 4 mm për prerëse bari**
 - Përshtatshmëri: për prerëse bari
 - Gjatësia: **minimumi 25 m**
 - Trashësi: **rreth 4 mm ±0,5 mm**
 - Material rezistent për prerje efikase
8. **Sharra të vogla**
 - Material: **çelik i fortë ose ekuivalent**

-
- Dhembë të përforcuar për rritje të jetëgjatësisë
 - Dorezë plastike ergonomike
 - Përshtatshme për dru, dërrasa, trungje
- 9. Bisht për lopatë, shatë, çapë, kosë, bel, kazmë**
- Gjatësia: **rreth 120 cm $\pm 5\%$**
 - Material: **dru natyral i trajtuar ose ekuivalent**
 - I punuar për rehati dhe qëndrueshmëri
- 10. Lopata**
- Përmasa koke: **40x20 cm $\pm 5\%$**
 - Materiali i kokës: **çelik i temperuar ose ekuivalent**
 - Pesha: **rreth 0.9 kg $\pm 10\%$**
 - Ngjyra: e zezë
 - E përshtatshme për transferimin e materialeve inerte
- 11. Kazmë**
- Material: **çelik i farkëtuar ose ekuivalent**
 - Përshtatshme për tokë të fortë, beton, gur, pllaka
 - Funksionale për bishta standard druri
 - Pesha: **rreth 1.5 kg $\pm 10\%$**
 - Forma: standarde për punime ndërtimi
- 12. Shatë**
- Peshë: **rreth 1200 gr $\pm 10\%$**
 - Material: **çelik i farkëtuar ose ekuivalent**
 - Shtresë antikorrozive (bojë e pjekur ose ekuivalente)
 - Gjerësi lame: **rreth 19 cm $\pm 5\%$**
- 13. Kosë**
- Materiali i tehut: **çelik special ose ekuivalent**
 - Gjatësi tehu: **rreth 600 mm $\pm 5\%$**
 - Bisht: **rreth 150 cm $\pm 5\%$** , dru natyral ose i trajtuar
 - Rezistencë e lartë për përdorim në fermë
- 14. Bel**
- Forma ovale
 - Përmasa: **23x27 cm $\pm 5\%$**
 - Pesha: **rreth 0.5 kg $\pm 10\%$**
 - Material: **çelik ose ekuivalent**
 - Përshtatshme për punimin e tokës
- 15. Sfurqe me bisht**
- Përmasat: **23 x 130 cm $\pm 5\%$**
 - Numri i dhëmbëve: **5 ± 1**
 - Material: **çelik ose ekuivalent**, rezistent ndaj korrozionit
 - Bisht druri ose material tjetër i fortë
- 16. Capë**
- DimENSIONI: **24 x 5.8 cm $\pm 5\%$**
 - Tipi: me dy dhëmbë
 - Materiali: **çelik ose ekuivalent**
 - Përshtatshme për punime kopshti dhe bujqësie
- 17. Lopatë e vogël për lule**
- Përmasa: **15 x 10 cm $\pm 5\%$**
 - Materiali i kokës: **çelik ose ekuivalent**
 - Bisht: dru ose plastik rezistent
 - Përdorim për mbjellje dhe krasitje
- 18. Kallë**
- Material: **çelik i farkëtuar ose ekuivalent**

-
- Bisht druri
 - Gjatësia: **rreth 120 cm $\pm 5\%$**
 - Qëndrueshmëri në përdorim të përsëritur
- 19. Krëhër**
- Bosht: **alumin ose material i lehtë dhe rezistent**
 - 27 fije plastike të sheshta të ngurtë
 - Parandalim rrëshqitjeje të gjetheve
 - Mbajtje e kokës anti-bllokim
- 20. Gur për kosë**
- Për mprehje
 - Material: **silikon karbid oksid ose ekuivalent**
 - Grane: **rreth 120**
 - Përmasat: **230x33x13mm $\pm 5\%$**
- 21. Kudhra**
- Përdorim për mprehje veglash
 - Material: **silikon karbid oksid ose ekuivalent**
 - Grane: **rreth 120**
 - Përmasa: **230x33x13mm $\pm 5\%$**
- 22. Tub uji (plastik i verdhë 3/4")**
- Material: **3 shtresa plastike rezistente ose ekuivalente**
 - Diametër: **3/4" $\pm 5\%$**
 - Rezistencë temperaturash: **-15 deri 60 °C**
 - Presion pune: **deri 24 bar $\pm 5\%$**
- 23. Karrocë dore me gomë**
- Kapacitet: **80 L $\pm 5\%$ / 160 kg $\pm 10\%$**
 - Struktura çeliku galvanizuar ose ekuivalente
 - Rrotë pneumatike
 - Doreza gome për komfort
 - Përshtatshme për përdorime të ndryshme
- 24. Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra**
- Material: **alumin ose ekuivalent**
 - Lartësi: **deri 3 m $\pm 5\%$**
 - Kapacitet mbajtës: **150 kg $\pm 5\%$**
 - Anti-rrëshqitje
 - Nr shkallësh: **2x6 ± 1**
- 25. Shinë për motosharrë Stihl MS461 (ose ekuivalent)**
- Përshtatje: **40–80 cm $\pm 5\%$**
 - Zinxhir **Oilomatic 33 RS3 ose ekuivalent**
 - Specifikime të përputhshme me MS461
 - Material çelik rezistent
- 26. Kandle për motosharrë Stihl MS461 (ose ekuivalent)**
- Specifikime: **tension / rezistencë / fileto për motor 76,5 cc**
 - Përshtatje: **MS461 ose ekuivalent**
 - Rezistente ndaj temperaturave të larta
- 27. Shinë për motosharrë Stihl MS441c (ose ekuivalent)**
- Përshtatje: **16" deri 30" $\pm 5\%$**
 - Zinxhir **3/8 RS Pro ose ekuivalent**
 - Përputhje për motor 70,7 cc
 - Specifikime standarde
- 28. Filtër ajri për motosharrë Stihl MS441c (ose ekuivalent)**
- Material: **filtrim i avancuar me fibra ose ekuivalent**
 - Përshtatje për MS441c

-
- Sistemi i pastrimit të ajrit me jetë të zgjatur
- 29. Tamburo litar për motosharrë Stihl MS441c (ose ekuivalent)**
- Përputhje me MS441c
 - Material: **çelik rezistent**
 - Montim standard sipas katalogut prodhues ose ekuivalent
- 30. Filtër ajri për motostekë Stihl HT75 (ose ekuivalent)**
- Përputhje me HT75
 - Material: **fibrash sintetike ose ekuivalente**
 - Sistemi i filtrimit të zgjeruar për jetëgjatësi
- 31. Thika për traktor korres Viking (ose ekuivalent)**
- Gjerësi prerjeje: **110 cm ±5%**
 - Sistem: **dy thika pjerre ose ekuivalente**
 - Përshtatje me motor 1–2 cilindra
 - Freksion elektromagnetik
- 32. Kandle për traktor korres Viking (ose ekuivalent)**
- Specifikime sipas motorit me 1–2 cilindra
 - Rezistente ndaj temperaturës së lartë
 - Fileto standarde ose ekuivalente
- 33. Koka për motostekë Stihl HT75 (ose ekuivalent)**
- Përshtatje 12 m gjatësi krasitëse
 - Tendosës zinxhiri anësor
 - Material rezistent ndaj konsumit
- 34. Disk për prerëse bari Stihl FS250 (ose ekuivalent)**
- Përshtatje: FS250
 - Material: **çelik i fortë ose ekuivalent**
 - Diametër standard
 - Rezistent ndaj konsumit
- 35. Karburator për prerëse bari Stihl FS250 (ose ekuivalent)**
- Përputhje FS250
 - Specifikime standarde për karburant benzine
 - Material: **aliazh alumini ose ekuivalent**
- 36. Fshesë me bisht plastik**
- Material: **plastik i fortë polipropilen ose ekuivalent**
 - Përmasa: **120 cm ±5% / koka 28x5 cm ±5%**
 - Fije të dendura
- 37. Fshesë të ashpra**
- Material: **fije sintetike rezistente ose ekuivalente**
 - Rezistencë kimike ndaj detergjentëve
 - Përdorim për sipërfaqe të forta
- 38. Qese mbeturinash të zeza (10 L)**
- Material: **plastik i fortë ose ekuivalent**
 - Ngjyra: e zezë
 - Përmasa: **53x65 cm ±5%**
 - Paketim: **sipas standarteve higjienike ose ekuivalente**
- 39. Qese mbetje 50–70 kg**
- Material: **plastik i qëndrueshëm ose ekuivalent**
 - Ngjyra: e zezë
 - Paketimi: **10 copë ±1**
 - Rezistencë për mbetje inerte ose të lagështa
- 40. Fryrëse gjethe**
- Shpejtësia fryrjes: **deri 210 km/h ±10%**
 - Fuqia fryrëse: **816 m³/h ±10%**

-
- Pesha: **rreth 2.45 kg $\pm 5\%$**
 - Materiali i trupit: plastik rezistent ose ekuivalent
- 41. Thithëse gjethe**
- Fuqia: **3000 W $\pm 10\%$**
 - Shpejtësia thithjes: **deri 240 km/h $\pm 10\%$**
 - Kapacitet: **rreth 650 m³/h $\pm 10\%$**
 - Përshtatshme për zona të gjera
- 42. Krëhër (për mbledhje gjethesh)**
- Material: plastik ose alumini rezistent
 - Rregullueshmëri e lartësisë
 - Përforcime kundër bllokimeve
 - Përdorim për kopshtari dhe pastrim
- 43. Bishta për krëhëra**
- Material: **dru ose material plastik rezistent**
 - Gjatësia: **rreth 100 cm $\pm 5\%$**
 - Forma ergonomike
 - Rezistencë e lartë ndaj konsumit
- 44. Mbledhëse mbeturinash me mekanizëm**
- Set me fshesë + lopatë
 - Mekanizëm mbylljeje parabolike
 - Shkop alumini ose plastik rezistent
 - Përshtatshme për pastrim urban
- 45. Çekiç dhe kulla kose**
- Material koke: **çelik ose ekuivalent**
 - Bisht: **dru ose material neutralizues dridhjes**
 - Pesha: **rreth 400 gr $\pm 5\%$**
 - Dizajnuar për goditje me impakt të ulët dhe precizion
- 46. Rreth kose**
- Material: **çelik ose ekuivalent**
 - Diametër: **rreth 40 mm $\pm 5\%$**
 - Rezistent ndaj korrozionit
 - Përforcim standard për kosë
- 47. Lopata teknologjike**
- Ngjyra: e zezë
 - Materiali i dorezës: **plastik ose ekuivalent**
 - Koka: **çelik ose ekuivalent**
 - Rezistencë për përdorim të gjatë
- 48. Set çelësash të ndryshëm (fiso)**
- Përmasa: **8–19 mm ± 1 mm**
 - Material: **krom-vanadium ose ekuivalent**
 - Përdorim profesional
 - Lehtësi në pastrim dhe ruajtje
- 49. Bombul gazi për temperim thikash**
- Temperatura: **deri 2400°C $\pm 5\%$**
 - Pesha: **rreth 330 gr $\pm 10\%$**
 - Gazi: super gaz ose ekuivalent
 - Komplet: bombul + pistolet
- 50. Pinca korenti**
- Dorezë: **e gomuar ose ekuivalente**
 - Maje: **çelik rezistent**
 - Izolim elektrik standard
 - Për aplikime elektrike dhe mekanike

51. Pompë për fryrje gomash

- Presioni pune: **0–12 bar $\pm 5\%$**
- Gjatësia tubit: **rreth 40 cm $\pm 5\%$**
- Lidhja BSP: **1/4" mashkull $\pm 5\%$**
- Material: plastik ose alumin rezistent

52. Kone sinjalizues për punime

- Përmasa: **70x34x34 cm $\pm 5\%$**
- Ngjyra standarde: portokalli me reflektues
- Material: plastik rezistent ose ekuivalent
- Përdorim për sinjalistikë rrugore

53. Tabela për njoftim punimesh në rrugë

- Material: **metal ose ekuivalent**
- Sipërfaqe e reflektueshme
- Përmasa standarde sipas normave rrugore
- Rezistente ndaj kushteve atmosferike

54. Levë (qysqi)

1. Përmasa: **16x600 mm $\pm 5\%$**
2. Material: **çelik karbon ose ekuivalent**
3. Rezistencë kundër korrozionit
4. Përdorim për nxjerrje armaturash dhe për ndarje elementësh betoni.

55. Varre

- Material: **çelik karboni i farkëtuar ose ekuivalent**
- Pesha: **rreth 4.5 kg $\pm 5\%$**
- Koka: e trajtuar termikisht për qëndrueshmëri
- Përdorim për goditjen e daltes, gurëve dhe tullave

56. Tub për vaditje “Botesh” ϕ 40

- Diametër: **40 mm $\pm 5\%$**
- Trashësi muri: **3.7 mm $\pm 5\%$**
- SDR: **11 $\pm 5\%$**
- PN: **10 bar $\pm 5\%$**
- Përputhshmëri: DIN 8077/1989 ose ekuivalente

57. Trapan dore (vidator) 20 V

- Bateri: **Litium-Ion 20V $\pm 5\%$**
- Shpejtësi: **0–400/0–1500 rpm $\pm 5\%$**
- Moment rrotullimi: **deri 45 Nm $\pm 5\%$**
- Pozicione rregullimi: **15+1 ± 1**
- Komplet i përfshin karikuesin

58. Komplet çelësa fiso 4–32 (set)

- Përmasa: **4–32 mm ± 1 mm**
- Material: **krom vanadium ose ekuivalent**
- Sistemi: **AS-DRIVE ose ekuivalent**
- Përfshin kapëse dhe kutinë e transportit

59. Komplet çelësa heksagonal (set)

- Madhësi: **1,5–10 mm $\pm 0,5$ mm**
- Material: **çelik S2 ose ekuivalent**
- Trajtim: kromim për rezistencë
- Set 9 copë

60. Çelës anglez universal (set)

- Material: **çelik karboni i forcuar ose ekuivalent**
- Gjatësi: **rreth 30 cm $\pm 5\%$**
- Kapje e rregullueshme manualisht
- Për aplikime të ndryshme mekanike

-
- Set 7 copë (6", 8", 10", 15", 20", 25", 30")
- 61. Komplet kacavidash kryq + yll (set)**
- Material tehu: **çelik silikoni-krom-vanadium ose ekuivalent**
 - Përfshirë dimensionet standarde: PH dhe PZ
 - Kacavida Kryq: minimumi 4 madhësi (PH0 – PH3), Kacavida Yll : minimumi 6 madhësi (T10 – T40).
 - Dorezë ergonomike, antirreshqitje
 - Përdorim profesional
- 62. Gur fresibël i vogël 850 W**
- Fuqia: **850 W $\pm 5\%$**
 - Rrotullime: **2800–11000 rpm $\pm 5\%$**
 - Diametri diskut: **125 mm $\pm 5\%$**
 - Pesha: **rreth 1.6 kg $\pm 10\%$**
 - Regjistër shpejtësie i përfshirë
- 63. Litar për vinxh**
- Ngarkesa maksimale: **5 ton $\pm 5\%$**
 - Gjatësia: **10 m $\pm 5\%$**
 - Gjerësia: **50 mm $\pm 5\%$**
 - Me arpion dhe grepa të dyfishte për sigurim
- 64. Kriketo për mjete**
- Set profesional me kapëse
 - Përmasa: **1/4", 3/8", 1/2" $\pm 5\%$**
 - Material: **krom-vanadium ose ekuivalent**
 - Përfshin të gjitha aksesoret standardë
- 65. Punto betoni me slit Ø 0.6-12**
- Diametër: **6–18 mm $\pm 0,5$ mm**
 - Material: **çelik karbon ose ekuivalent**
 - Këndi prerës: **130° $\pm 5^\circ$**
 - Kapje cilindrike të kromuara
- 66. Maskë për saldim me reze**
- Madhësia e fishekut: **110x90x9 mm $\pm 5\%$**
 - Sensori i harkut: **2 ± 1**
 - Klasa optike: **1/1/1/2 ose ekuivalente**
 - Ndezje/fikje automatike
- 67. Elektroda me pikë të kuqe (2.5 dhe 4 mm)**
- Tipi: **E6013 ose ekuivalent**
 - Diametër: **2.5–4 mm $\pm 0,5$ mm**
 - Gjatësia: **300 mm $\pm 5\%$**
 - Amperazhi: **50–100 A $\pm 10\%$**
- 68. Elektroda 2.5 dhe 4 mm**
- Përmasat: **2.5x300 mm $\pm 5\%$ dhe 4x4.5 mm $\pm 5\%$**
 - Pesha totale: **sipas paketimit $\pm 10\%$**
 - Material standard për saldim strukturash
- 69. Valixhe veglash**
- Përmasa: min. **450x360x640 mm $\pm 5\%$**
 - Me rrota për transport të lehtë
 - Material: plastik rezistent ose metal i lehtë
 - Përdorim profesional për organizimin e veglave
- 70. Kavo çeliku**
- Përmasa: **12x1000 mm $\pm 5\%$**
 - E veshur me PVC për mbrojtje
 - Përfshin 2 çelësa

-
- Rezistente ndaj konsumit
- 71. Fshesa të mëdha për fshirje asfalti**
- Material fijesh: **polipropilen ose ekuivalent**
 - Përmasa standarde për rrugë
 - Rezistente ndaj konsumit dhe kimikateve
 - Lehtë për manovrim
- 72. Leva hekuri të gjata 1.10 m**
- Përmasat: **16x1100 mm ±5%**
 - Material: **çelik ose ekuivalent**
 - Rezistente ndaj ndryshkut
 - Për ndarjen e elementëve në ndërtim
- 73. Leva hekuri të shkurtra 50 cm**
- Përmasat: **16x500 mm ±5%**
 - Material: **çelik ose ekuivalent**
 - Për ndërtim dhe riparime
- 74. Gërshërë për prerje telash**
- Gjatësia: **250 mm ±5%**
 - Kapacitet prerjeje: **1 mm inoks ±0,2 mm**
 - Material: **krom-vanadium ose ekuivalent**
 - Dorezë ergonomike e gomuar
- 75. Çelës kriketo profesionale**
- Përmasa: **1/4", 3/8", 1/2" ±5%**
 - Material: **krom-vanadium ose ekuivalent**
 - Komplet i përfshin të gjithë aksesoret standardë
 - Përdorim profesional
- 76. Pinca prerëse**
- Tipi: **diagonale ose ekuivalente**
 - Material: **çelik krom-vanadium ose ekuivalent**
 - Gjatësi: **rreth 6" ±5%**
 - Përshtatshme për prerje të forta
- 77. Pinca elektrike profesionale**
- Tension izolimi: **deri 1000 V ±5%**
 - Gjatësia: **8" ±5%**
 - Material: **çelik i trajtuar termikisht ose ekuivalent**
 - Dorezë ergonomike për siguri elektrike.
- 78. Pllaka guri fleksibël për prerje metali**
- Disqe për prerje metali me leter zmerile dhe perberje alumini te oksiduar, permasa te ndryshme: 115x3x22.2mm; 125x3x22.2mm; 180x3x22.2mm.
- 79. Pllaka guri fleksibël për prerje guri/betoni**
- Struktura kompozite dhe grimcat abrazive, mundesojne avancim te shpejte gjate punimit, permasa te ndryshme: 115x3x22.2mm; 125x3x22.2mm; 180x3x22.2mm.
- 80. Kabell 5x6 mm**
- Përbërja e përcjellësit është prej bakri. Është i disponueshëm në seksione dhe ngjyra të ndryshme. Ka dy shtresa izolimi prej materiali PVC, ngjyra e jashtme është gri, limitet e temperaturës janë -5..60°C në gjendje të lirë dhe -30..60°C i fiksuar.
Temperatura e punës: +5°C - +60° C on the conductor
Materiali i izolimit: PVC T12/PVC TM2.
- 81. Automat 3 fazor**
- Tensioni nominal AC : 230 V – 400V
o Mënyra e përdorimit: Kontroll ne distance
o Kategoria e përdorimit : A
o Frekuenca: 50/60 Hz

-
- o Numri i poleve : 4P
 - o Rryma nominal : 1-63A
 - o Kapaciteti i Thyerjes: 10kA
 - o Tensioni i izolimit : 500V
 - o Lartesi : 72 mm
 - o Gjeresi : 43 mm
 - o Thellesi : 45 mm dhe 85 mm
 - o Pesha : 145g/pol
 - o Tensioni nominal i perballimit te impulsit: 4 kV
 - o Faktori mbrojtës per morsetat : IP20
 - o Faktori mbrojtës frontal : IP40
 - o Klasa e kufizimit te energjise : 3
 - o Siperfaqja e percuesve te ngurte : minimumi 16 (mm²),maksimumi 35 (mm²)
 - o Siperfaqja e percuesve fleksibel : minimumi 16 (mm²),maksimumi 35 (mm²)
 - o Temperatura e referimit : +30 C

82. Automat i thjeshtë

Gjerësia: 35mm
Thellësia: 69mm
Tensioni: 230V
Numri i moduleve: 2

83. Priza 3-she

Materiali: Baker/Plastik
Tensioni: 230 V

84. Çelës hidraulik papagall

Nofull e levizshme prej celiku cilesis se larte me karbon me dimension 200mm-450mm

85. Shpatulle e madhe

Bazament prej alumini të anodizuar për qëndrueshmëri maksimale të fletës
Me dorezë ergonomike plastike me 2 materiale

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia e pritshme
1	Gërsërë krasitje per degë te larta.	copë	10
2	Gërsërë krasitje me zgjatim, çelik, 67.5-92.5cm	copë	20
3	Gershere krasitje, 65 - 87 cm, strukture metalike	copë	20
4	Zinxhir për motosharrë model Stihl MS 461 (ose ekuivalent)	copë	200
5	Limë për mprehjen e zinxhirit të motosharrës	copë	200
6	Gershere krasitje, 20 cm, me doreze plastike	copë	200
7	Filispanjë litar Ø 4 mm per Preresebari (filispanja)	ml	1000
8	Sharra të vogla	copë	30
9	Bisht për lopatë, shatë, çapë, kosë, bel, kazmë	copë	2000
10	Lopata	copë	250
11	Kazmë	copë	250
12	Shatë	copë	100
13	Kosë	copë	250
14	Bel	copë	160
15	Sfurqe	copë	150
16	Capë	copë	60
17	Lopatë e vogël (për lule)	copë	60
18	Kallë	copë	50
19	Krëhër	copë	150
20	Gurë për kalitjen e kosës (Gri)	copë	200
21	Kudhër per mprehjen e kosës	copë	50
22	Tub uji (plastik I verdhë 3/4)	ml	3000
23	Karroccë dore me gomë	copë	20
24	Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra	copë	15
25	Shinë për motosharrë model Stihl MS 461 (ose ekuivalent)	copë	50
26	Kandele për motosharrë model Stihl MS 461 (ose ekuivalent)	copë	30
27	Shinë për motosharrë model MS441c (ose ekuivalent)	copë	30
28	Filter ajri për motosharrë model Stihl MS441c (ose ekuivalent)	copë	50
29	Tamburo dhe litar për motosharrë model Stihl MS441c (ose ekuivalent)	copë	50
30	Filter Ajri për motostekë model Stihl HT75 (ose ekuivalent)	copë	50
31	Thika për traktorë korrës Viking	copë	50
32	Kandele për traktorë korrës	copë	50
33	Koka për motostekë model Stihl HT75 (ose ekuivalent)	copë	50

34	Disk për prerëse bari (filispanjë), model Stihl FS250 (ose ekuivalent)	copë	240
35	Karburator për prerëse bari (filispanjë), model Stihl FS251 (ose ekuivalent)	copë	10
36	Fshesë me bisht plastik	copë	250
37	Fshesë të ashpra	copë	100
38	Qese mbeturinash të zeza (10 L)	copë	1000
39	Qese mbetje 50-70 kg	copë	501
40	Fryrëse Gjethe	copë	10
41	Thithëse Gjethe	copë	10
42	Krehër (për të mbledhur gjethet)	copë	10
43	Bisht (Krehër për të mbledhur gjethet)	copë	15
44	Mbledhëse mbeturinash (me mekanizëm)	copë	20
45	Çekiç dhe Kulla Kose	copë	10
46	Rreth Kose	copë	10
47	Lopata Teknologjike	copë	30
48	Set Çelësash të ndryshëm (fiso)	set	20
49	Bombul gazi për temperim thikash	copë	10
50	Pinca korenti	copë	10
51	Pomë për fryrje gomash	copë	10
52	Kone sinjalizues per punime	copë	100
53	Tabela per njoftim punimesh ne rrugë	copë	45
54	Levë	copë	50
55	Varre	copë	15
56	Tub per vaditje 'Botesh' φ 40	ml	400
57	Trapan dore (Vidator) 22-Vat	copë	10
58	Komplet celsa fiso 4-32 (set)	set	10
59	Komplet celsa heksagonal (set)	set	10
60	Celsa anglez universal (set)	set	5
61	Komplet kacavidash kryq + yll (set)	copë	11
62	Gur Fresibel i vogel 850 vat	copë	5
63	Litar per vinxh	ml	100
64	Kriketo per mjete	copë	30
65	Punto Betoni me slit Ø 0.6-12	copë	20
66	Maske per saldim me reze	kg	5
67	Elektroda me pik te kuqe (2.5 dhe 4)	kg	100
68	Elektroda 2.5 dhe 4	set	200
69	Valixhe veglash	set	3
70	Kavo Çeliku	m	50
71	Fshesa të mëdha për fshirje asfalti	copë	25
72	Leva hekuri të gjata 110 cm	copë	15
73	Leva hekuri të shkurtra 50 cm	copë	15
74	Gërshërë për prerje telash (tronkes)	copë	15
75	Celsa kriketo profesionale	copë	16
76	Pinca prerëse	copë	15
77	Pinca elektrike profesionale	copë	15

78	Pllaka guri fleksibël për prerje metali	copë	200
79	Pllaka guri fleksibël për prerje guri/betoni	copë	200
80	Kabell 5x6 mm	ml	200
81	Automat 3 fazor	copë	10
82	Automat i thjeshtë	copë	20
83	Priza 3-she	copë	50
84	Çelës hidraulik papagall	copë	20
85	Shpatulle e madhe	copë	20

Afatet e lëvrimit: - Afati i marreveshjes kuadër është 12 muaj nga data e nënshkrimit dhe afati i lëvrimit të mallit është 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse

Vendi i dorëzimit të mallit është pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, rruga “5 Maji”

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit, për artikujt objekt prokurimi si më poshtë:

Nr.	Emertimi
1	Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra
2	Fryrëse Gjethe
3	Thithëse Gjethe
4	Mbledhëse mbeturinash (me mekanizëm)
5	Lopata Teknologjike
6	Komplet celsa fiso 4-32 (set)
7	Gur Fresibel i vogël 850 vat
8	Valixhe veglash
9	Pinca elektrike profesionale
10	Maske për saldim me reze

Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose te distributorit të autorizuar, në rast se nuk është prodhues. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, nga prodhuesi për të gjitha artikujt si me poshte:

Nr.	Emertimi
1	Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra
2	Fryrëse Gjethe
3	Thithëse Gjethe
4	Mbledhëse mbeturinash (me mekanizëm)
5	Lopata Teknologjike
6	Komplet celsa fiso 4-32 (set)
7	Gur Fresibel i vogel 850 vat
8	Valixhe veglash
9	Pinca elektrike profesionale
10	Maske per saldim me reze

2.3.5 Operatori ekonomik, për produkte e pikes 2.3.4, duhet të paraqesë “Ofertë Teknike” në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen nga ofertuesi për të gjithë zerrat objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr.	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa, web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD i produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

Emri, Adresa dhe website i kompanise prodhuese, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim, Emertimi i Katalogut të prodhuesit., Referenca në katalogje, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku autoriteti kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare,

profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuara nga autoriteti kontraktor përfitues.

Shënim: *Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

